

410 VARIANTI I PIKËQASJES – EMËR ORGANIZATE

Fusha përmban variantin e pikëqasjes për formën e emrit të organizatës.

Emrat e njësisve politike-territoriale, të cilat përdoren si pikëqasje për autorët, trajtohen si organizata (fusha 410). Si organizata trajtohen edhe emrat e njësisve politike-territoriale, pas të cilëve vjen nënndarja për organizatën dhe e cila përdoret si pikëqasje për autorët ose si pikëqasje lëndore. Emrat e njësisve politike-territoriale që përdoren si pikëqasje lëndore, si të vetme ose vetëm me përcaktuesit e shtuar lëndorë, trajtohen si emra të territoreve (fusha 415).

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
410	Varianti i pikëqasjes – emër organizate	r
a	<i>Elementi hyrës</i>	nr
b	<i>Nënndarje</i>	r
c	<i>Shtesa të emrit ose cilësori</i>	r
d	<i>Numri i mbledhjes</i>	nr
e	<i>Vendi i mbledhjes</i>	r
f	<i>Viti i mbledhjes</i>	nr
g	<i>Elementi i përmbysur</i>	nr
h	<i>Pjesa e emrit (jo elementi hyrës ose i përmbysur)</i>	nr
j	<i>Përcaktuesi i formës</i>	r
x	<i>Përcaktuesi i përgjithshëm</i>	r
z	<i>Përcaktuesi kohor</i>	r
2	<i>Kodi i sistemit</i>	nr
3	<i>Numri i regjistrimit</i>	nr
5	<i>Kodi për marrëdhënien</i>	nr
7	<i>Shkrimi i pjesës kryesore të pikëqasjes</i>	nr
8	<i>Gjuha e katalogimit</i>	nr
9	<i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		Lloji i organizatës
	0	<i>emër organizate</i>
	1	<i>mbledhje</i>
2		Mënyra e shënimit të emrit
	0	<i>emër në formë të përmbysur</i>
	1	<i>emër sipas vendit ose juridiksionit</i>
	2	<i>emër në renditje të drejtë</i>

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat nga a deri h janë përshkruar tek fusha 210, nënfusha j, x dhe z në kapitullin *Përcaktuesit*, ndërsa nënfusha 2, 3, 5, 7, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Pikëqasja në fushën 410 është varianti i pikëqasjes në fushën 2XX dhe është përcaktuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore.

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

210 *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR ORGANIZATE*

SHEMBUJ

1.

210	02	a Delaware Racing Commission
410	01	a Delaware. b Racing Commission

2.

210	02	a Schweizerisches Rotes Kreuz
410	02	a Croix-Rouge suisse

3.

210	12	a Symposium on Endocrines and Nutrition f (1956 ; e University of Michigan)
410	12	a Nutrition Symposium f (1956 ; e University of Michigan)

4.

210	02	a D.B. Lister & Associates
410	00	a Lister g D.B. & Associates

5. * COBISS.net

210	02	a Institut i Shkencave të Informacionit c Maribor
410	02	5d a IZUM
410	02	a Institute of Information Science c Maribor

Shfaqja e regjistrimit të njësuar:

Instituti i Shkencave të Informacionit (Maribor)

< IZUM (akronim)

6. * COBISS.net

210	12	a Asociacioni për Menaxhimin e Projekteve b Forum i projektit f 2001 e Tiranë
410	12	a AMP b Forum i projektit f 2001 e Maribor

7. * COBISS.net

210	02	a Muzeu Historik Kombëtar c Tiranë
410	02	a Albanian National Museum c Tirana
410	02	a Le Musée National d'Histoire c Tirana

8. * COBISS.net

210	02	a Bashkësia e Shteteve të Pavarura
410	02	9 fre a CEI
410	02	9 eng a CIS
410	01	9 eng a Commonwealth of Independent States
410	02	9 fre a Communauté des Etats indépendants
410	02	a SND
410	02	9 slv a Skupnost neodvisnih držav
410	02	2 ram 3 FRBNF12333917 5 n 8 fre a Communauté des Etats indépendants
410	01	2 sears 3 SSEA94000034 5 n 8 eng a Commonwealth of Independent States <i>(Regjistrim nga SGC. Në fushën 410 janë termat për Bashkësinë e Shteteve të Pavarura në gjuhët e tjera dhe shkurtesat për të. Pikëqasjet e njësuara për Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, të formuara sipas rregullave nga sistemet e tjera të emërtimeve lëndore, gjithashtu vendosen në fushën 410.)</i>

9. * COBISS.net

210	02	a Koloseumi c Romë, Itali
410	02	9 lat a Amphitheatrum Flavium c Romë, Italia
410	02	9 ita a Anfiteatro Flavio c Romë, Italia
410	02	9 fre a Colisée c Romë, Italia
410	02	9 eng a Coliseum c Romë, Italia
410	02	9 ita a Colosseo c Romë, Italia
410	02	9 eng a Colosseum c Romë, Italia
410	02	a Amfiteatri Flavius c Romë, Italia
410	02	2 lc 3 sh 87004621 5 n 8 eng a Colosseum (Rome, Italy)
415	□□	2 ram 3 FRBNF1194862 5 n 8 fre a Rome (Italie) x Colosseo <i>(Regjistrim nga SGC. Në sistemin LCSH Koloseumi romak është trajtuar si organizatë, për këtë arsye është vendosur në fushën 410. Në sistemin RAMEAU është trajtuar si emër gjeografik dhe si rezultat i kësaj është vendosur në fushën 415.)</i>